



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**GJYKATA KUSHTETUESE**

---

*STATISTIKA PËR VEPRIMTARINË  
GJYQËSORE TË GJYKATËS KUSHTETUESE*

---

---

*PËR 9-MUJORIN E VITIT 2024*

---

## KËRKESAT DREJTUAR GJYKATËS KUSHTETUESE GJATË 6-MUJORIT TË PARË TË VITIT 2024

Gjatë 9-mujorit të vitit 2024 Gjykata Kushtetuese ka pasur **409 kërkesa**, nga të cilat 316 kërkesa janë paraqitur dhe regjistruar gjatë 9-mujorit të parë të vitit 2024, si dhe 93 kërkesa janë mbartur nga viti 2023.

### KOHËZGJATJA

- ❖ Gjykata ka respektuar të gjitha afatet procedurale të kërkesave, në përputhje me parashikimet e ligjit organik të Gjykatës, si dhe me Rregulloren për Procedurat Gjyqësore në Gjykatën Kushtetuese.
- ❖ Mesatarja e shqyrtimit të çështjeve në Gjykatë për vendimet përfundimtare është 8 muaj dhe për vendimet e moskalimit 3 muaj.
- ❖ Aktualisht Gjykata Kushtetuese nuk ka në shqyrtim asnjë çështje të prapambetur.
- ❖ Vlen të theksohet fakti që në Gjykatë nuk është paraqitur asnjë kërkesë për tejzgjatje të procesit para Gjykatës Kushtetuese.

### ❖ Vendimet e marra nga Gjykata Kushtetuese gjatë 9-mujorit të parë të vitit 2024.

Gjykata Kushtetuese gjatë 9-mujorit të vitit 2024 ka dhënë në total **273 vendime**, 63 vendime përfundimtare dhe 210 vendime moskalimi, si dhe ka në shqyrtim ende pa vendimmarrje 131 çështje<sup>1</sup>.

### Vendimmarrje dhe çështje në shqyrtim gjatë 9-mujorit të vitit 2024



<sup>1</sup> Numri total i vendimeve dhe çështjeve në shqyrtim nuk korrespondon me numrin total të kërkesave për shkak të kërkesave të bashkuara.

- ❖ Theksojmë se të gjitha vendimet përfundimtare dhe vendimet e moskalimit janë publikuar dhe zbardhur brenda afateve ligjore.
- ❖ Të gjitha vendimet e Gjykatës Kushtetuese janë të arsyetuara përfshirë edhe vendimet e moskalimit të cilat janë të arsyetuara për kriteret e pranueshmërisë.

Më poshtë paraqesim të dhëna statistikore për kërkesat e paraqitura gjatë 9-mujorit të vitit 2024, të grupuara sipas subjekteve që vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese, si dhe objektit të kërkesës:

❖ Kërkesat e grupuara sipas subjekteve që vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese:

- ✚ 5 kërkesa janë paraqitur nga një grup deputetësh;
- ✚ 1 kërkesë është paraqitur nga një parti politike;
- ✚ 1 kërkesë është paraqitur nga Këshilli i Ministrave;
- ✚ 1 kërkesë është paraqitur nga Kryetari i Gjykatës Kushtetuese;
- ✚ 8 kërkesa janë paraqitur nga organizatat;
- ✚ 300 kërkesa janë paraqitur nga individët.



❖ Kërkesat e grupuara sipas objektit:

- ✚ 20 kërkesa janë paraqitur për papajtueshmërinë e ligjeve (ose dispozitave të veçanta të tyre) me Kushtetutën;
- ✚ 1 kërkesë është paraqitur për zgjidhjen e konfliktit të kompetencave dhe shfuqizimin e vendimit të Kuvendit të Shqipërisë;
- ✚ 1 kërkesë është paraqitur për shfuqizimin e vendimit të Këshillit të Ministrave;
- ✚ 4 kërkesa janë paraqitur për shfuqizimin e akteve të pushtetit publik;
- ✚ 2 kërkesa janë paraqitur për shfuqizimin e vendimeve të gjykatave të juridiksionit të zakonshëm dhe papajtueshmërinë e ligjeve (ose dispozitave të veçanta të tyre) me Kushtetutën;
- ✚ 239 kërkesa janë paraqitur për shfuqizimin e vendimeve të gjykatave të juridiksionit të zakonshëm;
- ✚ 11 kërkesa janë paraqitur për konstatimin e cenimit të së drejtës si rezultat i mosgjyqimit brenda një afati të arsyeshëm;
- ✚ 25 kërkesa janë paraqitur për shfuqizimin e vendimeve të gjykatave të juridiksionit të zakonshëm, së bashku me konstatimin e cenimit të së drejtës si rezultat i mosgjyqimit brenda një afati të arsyeshëm;
- ✚ 1 kërkesë është paraqitur për deklarimin e mbarimit të mandati të anëtarit të Gjykatës Kushtetuese;
- ✚ 12 kërkesa janë paraqitur për interpretimin/korrigjimin/rishikimin e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese.




## VENDIMET E MARRA NGA GJYKATA KUSHTETUESE GJATË 9-MUJORIT TË VITIT 2024

Më poshtë paraqesim në mënyrë grafike 63 vendimet përfundimtare të grupuara sipas subjekteve që vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese, sipas objektit të kërkesës, sipas dispozitivit të vendimit, si dhe sipas mënyrës së votimit.

❖ Vendimet përfundimtare të marra gjatë 9-mujorit të vitit 2024 të grupuara sipas subjekteve që vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese:


- ✚ 7 vendime u përkasin kërkesave të paraqitura nga një grup deputetësh;
- ✚ 1 vendim i përket kërkesës së paraqitur nga gjykatat e sistemit të zakonshëm (kontroll incidental);
- ✚ 4 vendime u përkasin kërkesave të paraqitura nga organizatat;
- ✚ 1 vendim i përket kërkesës së paraqitur nga Kryetari i Gjykatës Kushtetuese;
- ✚ 50 vendime u përkasin kërkesave të paraqitura nga individët.



❖ Vendimet përfundimtare të marra gjatë 9-mujorit të vitit 2024, të grupuara sipas objektit të kërkesës:

- 1 vendim i përket kërkesës me objekt papajtueshmërinë e marrëveshjes ndërkombëtare me Kushtetutën;
- 9 vendime u përkasin kërkesave me objekt papajtueshmërinë e ligjeve me Kushtetutën;
- 2 vendime u përkasin kërkesave me objekt zgjidhjen e konfliktit të kompetencave dhe shfuqizimin e vendimit të Kuvendit të Shqipërisë;
- 1 vendim i përket kërkesës me objekt deklarimin e mbarimit të mandatit të gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese;
- 38 vendime u përkasin kërkesave me objekt shfuqizimin e vendimeve të gjykatave të sistemit të zakonshëm në kuadër të procesit të rregullt ligjor;
- 1 vendim i përket kërkesës me objekt shfuqizimin e vendimeve të gjykatave të sistemit të zakonshëm në kuadër të procesit të rregullt dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave;
- 11 vendime u përkasin kërkesave me objekt konstatimin e cenimit të së drejtës si rezultat i mosgjyqimit brenda një afati të arsyeshëm.


## Vendime të grupura sipas objektit



❖ Vendimet përfundimtare të marra gjatë 9-mujorit të vitit 2024 të grupuara sipas dispozitivit të vendimit:


- Për 25 vendime Gjykata ka vendosur *pranimin e kërkesës*;
- Për 12 vendime Gjykata ka vendosur *pranimin e pjesëshëm*;
- Për 25 vendime Gjykata ka vendosur *rrëzimin e kërkesës*.

## Vendimet përfundimtare të grupuara sipas dispozitivit



❖ Vendimet përfundimtare të marra gjatë 9-mujorit të vitit 2024 të grupuara sipas mënyrës së votimit:

- 29 vendime janë *njësëri*;
- 34 vendime janë me *shumicë votash*.



Gjatë 9-mujorit të vitit 2024 nga Mbledhja e Gjyqtarëve dhe Kolegjet e Gjykatës Kushtetuese janë marrë 210 vendime moskalimi.


Më poshtë paraqesim në mënyrë grafike vendimet e moskalimit të grupuara sipas subjekteve që vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese, objektit të kërkesës, si dhe Kolegjeve/Mbledhjes së Gjyqtarëve.

❖ Vendimet e moskalimit të grupuara sipas subjekteve që vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese:

- ✚ 2 vendime u përkasin kërkesave të paraqitura nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm (kontroll incidental);
- ✚ 2 vendime u përkasin kërkesave të paraqitura nga shoqatat;
- ✚ 205 vendime u përkasin kërkesave të paraqitura nga individët;
- ✚ 1 kërkesë i përket kërkesës së paraqitur nga Këshilli i Ministrave.




## Vendimet moskalimi të grupuara sipas subjekteve që vënë në lëvizje Gjykatën



➤ Vendime moskalimi të marra gjatë 9-mujorit të vitit 2024 të grupuara sipas objektit të kërkesës:

- ✚ 9 vendime u përkasin kërkesave të paraqitura për papajtueshmërinë e ligjeve (ose dispozitave të veçanta të tyre) me Kushtetutën;
- ✚ 2 vendime u përkasin kërkesave të paraqitura për papajtueshmërinë e ligjeve (ose dispozitave të veçanta të tyre) me Kushtetutën dhe shfuqizimin e vendimit të Këshillit të Ministrave;
- ✚ 2 vendime u përkasin kërkesave të paraqitura për kundërshtimin e akteve të pushtetit publik;
- ✚ 4 vendime u përkasin kërkesave të paraqitura për kundërshtimin e vendimeve të gjykatave të juridiksionit të zakonshëm dhe papajtueshmërinë e ligjeve (ose dispozitave të veçanta të tyre) me Kushtetutën;
- ✚ 164 vendime u përkasin kërkesave të paraqitura për kundërshtimin e vendimeve të gjykatave të juridiksionit të zakonshëm në kuadër të procesit të rregullt ligjor;


- ✚ 5 vendime u përkasin kërkesave të paraqitura për konstatimin e cenimit të së drejtës si rezultat i mosgjykimit brenda një afati të arsyeshëm;
- ✚ 10 vendime u përkasin kërkesave të paraqitura për kundërshtimin e vendimeve të gjykatave të juridiksionit të zakonshëm së bashku me konstatimin e cenimit të së drejtës si rezultat i mosgjykimit brenda një afati të arsyeshëm;
- ✚ 14 vendime u përkasin kërkesave të paraqitura për interpretimin/korrigjimin/saktësimin/rishikimin e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese.



➤ Vendime moskalimi të marra gjatë 9-mujorit të vitit 2024 nga Kolegjet dhe Mbledhja e Gjyqtarëve:

- ✚ 176 vendime janë marrë nga Kolegjet e Gjykatës Kushtetuese;
- ✚ 34 janë marrë nga Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese.

### Vendime moskalimi të marra nga Kolegjet dhe Mbledhja e Gjyqtarëve



Aktualisht (datë 01.10.2024) numri total i kërkesave që presin të shqyrtohen nga Gjykata Kushtetuese është **131**, nga të cilat:

- ✚ 37 kërkesa janë në shqyrtim në seancë plenare;
- ✚ 6 kërkesa janë në shqyrtim paraprak në Mbledhjen e Gjyqtarëve;
- ✚ 88 kërkesa janë në fazën e shqyrtimit paraprak nga Kolegjet e Gjykatës Kushtetuese.

*Tetor 2024*

**Përgatiti:**

**Drejtoria Gjyqësore dhe e Dokumentacionit**